



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

# BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

TETOR, 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet ne pasqyrën ne formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 te çdo muaji. Te dhënat e agreguara te pasqyrës 14 sh për muajin Tetor janë te dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

## 1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Tetor 2018 zënë 38,75 % te totalit te sëmundjeve infektive te raportuara me ane te Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 255,56/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë te shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore ne grupin e sëmundjeve diarreike.

Në muajin tetor është raportuar një rast i dyshuar me Tifo abdominale nga rrethi i Vlorës i grup-moshës 50-54 vjeç. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin tetor 2018 me incidence 3.31/10.000 banore ndjekur nga Berati me vetëm tre raste me Salmoneloze jotifoide. Nga 58 raste te dyshuara 56 raste janë te konfirmuara me Salmonelozës jotifoide për muajin tetor 2018.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidencës së Shigelozës për muajin tetor 2018 ne nivel kombëtar përkatësisht me incidencë 1.38/10.000 banorë.

Ndërkohe qe ne nivel kombëtar toksikoinfektionet alimentare paraqesin një incidencë 7.29/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kavajë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore ne raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike ne Tetor 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)


|  | Raste,<br>Tetor 2018 | Incidenca Tetor 2018<br>(raste/100.000 banorë) |
|--|----------------------|--|
| Tifo abdominale + Paratifo               | 1                    | 0.04   |
| Salmonelozë                              | 58                   | 2.07   |
| Shigeloze (Disenteri bacilare)           | 23                   | 0.82   |
| Dizenteri amebike                        | 0                    | 0  |
| Toksikoinfeksione alimentare             | 204                  | 7.29   |
| Gastroenterite<br>(etiologji e panjohur) | 6870                 | 245,35   |
| Semundje diarreike ne total              | 7156                 | 255.56   |

## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1. Fruthi

Gjatë muajit tetor 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 37 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv vetëm 18 raste. Nga këto 17 raste i përkasin rrethit të Tiranës dhe 1 rast rrethit të Krujës. Rastet pozitive i përkasin kryesisht grupmoshës pediatrike (0-14 vjeç) me 11 raste nga të cilat 7 raste janë në grupmoshën nën 2 vjeç (7 raste). Kjo vazhdon të jetë grupmosha me e prekur për shkak edhe të mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës të mëparshëm të tyre në shërbimin pediatrik QSUT. Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Tetor 2018



## 2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit tetor 2018 janë raportuar 23 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe 5 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Grupmosha e prekur është ajo adulte. Nga 23 raste te suspektuara 18 janë te konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar dhe nga 5 raste te suspektuara me Tuberkuloz ekstrapulmonar vetëm tre janë te konfirmuara.

## 3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.25/100.000 banore për muajin tetor 2018. Rastet për muajin tetor 2018 me Bruceloze janë raportuar nga rrethet Lushnjë, Librazhd, Gjirokastrë, Mat dhe Pogradec. Gjatë muajit tetor në pasqyrën 14 sh janë raportuar dy raste te suspektuara me Antraks nga rrethet Kukës dhe Vlore. Ndërkohë gjatë kësaj periudhe kemi vetëm një rast te konfirmuar nga Lushnja me Leptospirozë i grup-moshës 55-59 vjeç dhe një rast te konfirmuar me Leishmanie viscerale te grup moshës 1-4 vjeç nga rrethi i Beratit.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidenat e sëmundjeve Zoonotike ne Tetor 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

|                        | Raste,<br>Tetor 2018 | Incidenca Tetor 2018<br>(raste/100.000 banore) |
|------------------------|----------------------|--|
| Antraks (Plasje)       | 2                    | 0.07   |
| Brucelozë              | 7                    | 0.25   |
| Leptospirozë           | 1                    | 0.04   |
| Leishmaniaza viscerale | 1                    | 0.04   |
| Leishmaniaza kutane    | 0                    | 0  |

#### 4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor te sëmundshmërisë infektive gjate muajit tetor 2018 janë raportuar ne total 18 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.64/100.000 banore) nga te cilat 8 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar, 3 raste Hepatit viral akut as A as B dhe 7 raste Hepatit viral B.

Ne lidhje me HBV, 7 rastet janë raportuar përkatësisht; 3 raste nga rrethi i Lushnjës, 2 raste nga Laçi, një rast nga Fieri dhe një nga Tirana. Nga shtate rastet e raportuara, gjashte janë te konfirmuara.

#### 5. Meningoencefalite

Gjate muajit Tetor 2018 janë raportuar ne total 3 raste meningoencefalite bazuar neurvejancën case based te tyre. Rastet janë nga Tirana, me predominim te meshkujve ne raport 2:1 dhe rastet i përkasin grup-moshës pediatrike, përkatësisht 2 rastet e dyshuar meningit bakterial te grup moshës <1 vjeç dhe 4-9 vjeç ndërsa rasti i dyshuar meningit viral i përket grup moshës 4-9 vjeç. Rastet e dyshuar si meningit bakterial kane rezultuar pas punksionit lumbar me prezence te celulave ne nivelin mbi 1000 qel/mm<sup>3</sup> por nuk është evidentuar lloji i shkaktarit, ndërsa për rastin e dyshuar si meningit viral pas punksionit lumbar niveli i celulave ka rezultuar 55 qel/mm<sup>3</sup> dhe nuk është testuar për shkaktarin viral. Duke u mbështetur ne kliniken e secilit rast dhe ne ekzaminimin e likuorit cerebrospinal pranë laboratorit te QSUT, rastet janë raportuar ne DRSHP Tirane si meningite bakterial jo

meningokoksik dhe meningit viral. Theksojmë qe rastet nuk kane patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe kane patur ecuri te mire klinike.

INSTITUTI I  
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI